

# RAPORT PARAPRAK I VLERËSIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

## OBJEKTI

**“ Ura Lidhëse për Fshatrat Vermosh -  
Velan - Velipojë ”.VITI 2023**

LENI-ING SHPK

## **HYRJE**

Qëllimi i realizimit të këtij projekti është, “ **Ura Lidhëse për Fshatrat Vermosh - Velan - Velipojë** ”, Njesia Administrative Kelmend ne Bashkine Malesia e Madhe, me realizimin e këtij projekti synohet krijimi i një lidhje te dy brigjeve te lumit nepermjet infrastruktures rrugore dhe lehtësimin e levizjes së banoreve dhe automjeteve. Aksi i ures ne projekt është perbri ures pasarel qe është aktualisht funksionale per lidhjen e dy zonave, dhe perpendikular me rrjedhjen e lumit. Ura ka gjerësi kaluese 4m, per nje makine. Shkembimi do te behet ne hyrje-daljet e saj, duke krijuar trup rruge te mjaftueshem per shkembimin e tyre. Ne projekt është parashikuar zgjerim i rrugëve hyrse deri ne 8m per te mundësuar shkembimin ne keto segmente. Ndertimi i kesaj ure lidhese do te jete nje lehtësim si per banoret e zones ashtu edhe per turizmin.

Ky raport paraprak i vleresimit te ndikimit ne mjedis ka per qellim te pershkruaje, identifikojë dhe vlerësojë efektet e mundshme domethënëse të zbatimit te projektit me elementet e vet perberes te planifikuar konform standarteve te projektimit. Vleresimi i Ndikimit Mjedisor identifikon, pershkruan dhe vlereson efektet direkte te projektit tek: njerezit, flora dhe fauna, ujrat sipërfaqesore dhe nentokesore, klima, terrenin dhe ndertimi tij dhe nderveprimin e ketyre faktoreve me trashëgimine kulturore, sociale dhe mijedisore. Kjo teme është bazuar ne parimet e veprimeve te parandalimit, dhe si e tille politika me e mire konsiston ne menjanimin e ndotjes dhe problemeve te tjera qe jane ngritur, me te drejte dhe qe ne fillim, me mire se sa te luftohen efektet e tyre ne rrjedhim.

VNM e këtij studimi është hartuar për të integruar mbrojtjen ambjentale, në jetën e përditëshme që të udhëheqë në ndryshimin e sjelljes së komunitetit, duke u bërë në këtë mënyrë forca shtytëse e përmiresimit të vazhdueshem të ndergjegjësisimit. Qëllimi i këtij raporti të vlerësimit në mjedis të pergatitur për rikonstruksionin e rrugëve është që të indentifikojë pasojat e mundëshme negative mjedisore që mund të krijohen si gjatë kryerjes së punimeve në keto rrugë por edhe gjatë shfrytëzimit, si dhe të rekomandojë zgjidhje për uljen e impaktit në atë mjedis .

Gjithashtu një synim tjetër është të përcaktojë dhe rekomandojë masat teknikeorganizative për zbutjen e anëve negative që mund të krijohen gjatë zvellimit të aktivitetit. Gjatë kryerjes së punimeve ndërtuesi do të marrë të gjitha masat për zbatimin me perpikmëri të projektit të hartuar, qe ai të sigurojë nje zhvillim normal të punimeve pa demtuar mjedisin

## **1.PROÇEDURA DHE PROÇESI I VNM-së**

### **1.1.Struktura e raportit te VNM-së**

**Objektivat e VNM-së** konsistojnë në analizimin e faktorëve lokale e negative mjedisor , në dhënien e masave zbutëse për reduktimin e masave negative , si dhe tenton në reduktimin e vlerave negative , si dhe tenton në përmirësimin e vlerave ekologjike e rikrijuese të territorit gjatë ndërtimit dhe funksionojnë të objektit.

**Qëllimi i VNM-së** është që nëpërmjet vlerësimit cilësor e sasior paraprak të parametrave hidrologjike e treguesve gjeologo-inxhinierike , parametrave sizmotektonike , morfologjike dhe gjeomorfologjike të bazuara në kriteret e standarteve shkencore ndërkombëtare , të tipizohen dhe të përzgjidhen një sere parametrash dhe veçorish të sistemeve të sipërmendura natyrore, në shërbim të infrastruktures mjedisore , të infrastruktures urbane si dhe ndërtimit

dhe shfrytëzimit të ndërtimit të objektit: “ **Ura Lidhëse për Fshatrat Vermosh - Velan - Velipojë** ”, **Njesia Administrative Kelmend ne Bashkine Malesia e Madhe.**

Qëllimi i hartimit të raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është marrja parasysh e faktorëve që ndikojnë në mjedis , evidentimi i aspekteve dhe analiza e impaktit të tyre gjatë ndërtimit të objektit dhe funksionimit të tij. Raporti ka si qëllim të jape një vështrim të përgjithshëm mbi efektet në mjedis , alternativat e mundshme dhe masat zbutëse të efekteve të padëshirueshme. Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM) është një studim që synon parashikimin e të gjithë efekteve të pritshme në mjedis, që do të rezultojnë nga një projekt i propozuar, si gjatë zbatimit ashtu edhe gjatë funksionimit të tij. VNM-ja përfshim gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse të ndikimit të projektit në mjedisin fizik dhe social me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së mjedisit nëpërmjet : Marjes në konsiderate të çështjeve mjedisore që në fazën e përgatitjes së propozimeve në projekt Shqyrtimit të alternativave të ndryshme brenda projektit. Nxjerrjes në dukje dhe vlerësimit cilësor me pika të ndikimeve në mjedis të projektit. Propozime të masave zbutëse të ndikimit në projekt VNM-ja e këtij projekti është hartuar për të integruar mbrojtjen e ambientit në jetën e përditshme , që të udhëheqë në ndryshimin e sjelljes së komunitetit , duke u bërë në këtë mënyrë forva shtytëse e përmirësimit të vazhdueshëm.

Jane mbajtur parasysh elementet kryesore strategjike te mbrojtjes se mjedisit, te renditur si me poshte:

- Parandalimi dhe ulja e ndotjes se ujit, ajrit, tokes dhe ndotjeve te tjera te cdo lloji
- Ruajtja e shumellojshmerise biologjike sipas bazes natyrore, biogeografike te vendit
- Perdorimi racional i burimeve natyrore e minerare dhe shmangia e mbishfrytezimit te tyre
- Riaftesimi ekologjik i zonave te demtuara dhe te ndotura nga veprimtaria e njeriut dhe dukurite natyrore shkaterruese
- Ruajtja e ekuilibrit ekologjik dhe permiresimi i cilesise se jetes.

Studimi ka marre parasysh mbrojtjen e mundshme maksimale te biodiversitetit, parandalimin e problemeve te mundshme mjedisore ne te ardhmen. Elementet baze te metodologjise se perdorur e trajtojne zhvillimin e kesaj zone si nje proces te vazhdueshem dhe adaptiv te administrimit te burimeve Ne kete drejtim, ka rendesi kuptimi i plote i marredhenieve midis vleresimit te sakte te vleres se pasurive natyrore, perdorimit efektiv te tyre dhe ndikimit te ndersjellte midis zhvillimit ekonomik te venidit dhe ruajtjes se mbrojtjes se mjedisit.

Shprehja e marredhenieve te mesiperme ne terma fizike e mjedisore, si dhe ne terma ekonomike, ndihmon ne planifikimin, formulimin e politikave, zbatimin dhe kryerjen e Vleresimit te drejte te ndikimit ne mjedis te objektivave te planifikuara per ndertimin ne zonen ne studim.

Konkretisht studimi i VNM-se per projektin ne fjale ka marre parasysh:

- *Ruajtjen maksimale te mundshme te mjedisit, e cila realizahet nepermjet:*

- Sugjerimit te perzgjedhjes se alternativave me me pak ndikime negative ne mjedis,

Perdorimit te burimeve energjitike me efekt minimal ne mjedis.

## **1.2.Vleresimi i ndikimit ne mjedis te veprimtarive ndertuese**

Ky ligj synon një vlerësim të përgjithshëm, të integruar dhe kohor të impaktit në mjedis të projekteve dhe veprimtarive që po zbatohen, duke parandaluar ose kufizuar impaktin negativ në mjedis. Ligji parashtron rregullat, procedurat, afatet, të drejtat dhe detyrat mbi çështjet e mëposhtme:

- Për të identifikuar, ndrequr dhe vlerësuar ndikimet e drejtpërdrejta dhe ato të tërthorta të projektit mbi mjedisin ku ai do të zbatohet;
- Për të krahasuar përparësitë dhe mangësitë e projektit të propozuar, duke vlerësuar alternativat ku përfshihen:
- Vendodhja ku do të zbatohet projekti;
- Përmasat dhe kapaciteti i tij;
- Teknologjia që do të zbatohet;
- Krahasimet me gjendjen e mjedisit në rast se projekti zbatohet;
- Përcaktimi i masave për të parandaluar ose kufizuar dëmtimet në mjedis;
- Sigurimi i një përpunimi teknik, profesional, ligjor dhe administrativ të kërkesës dhe vendim-marrjes nga organet përkatëse.

## **Hartimi i raportit mjedisor**

1. Raporti mbi zhvillimin urban duhet të bëjë identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të mundshme në zbatimin e planit për mjedisin, si dhe të japë alternativa të arsyeshme.
2. Raporti mjedisor duhet të përfshijë pikat e mëposhtme:
  - a) Një përmbledhje të përmbajtjes dhe objektivave kryesore të planit.
  - b) Aspekte përkatëse të gjendjes aktuale të mjedisit dhe zhvillimin e pritur të tij.
  - c) Karakteristikat mjedisore të zonave që ka të ngjarë të ndikohen nga ai.
  - d) Ndikimet e mundshme në mjedis, duke përfshirë shëndetin e njeriut, florën, faunën, biodiversitetin, tokën, klimën, ajrin, ujin, peisazhin, zonat natyrore, vlerat materiale, trashëgiminë kulturore dhe ndërveprimin ndërmjet faktorëve.
  - e) Objektivat për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuar në nivelin kombëtar.
  - f) Masat e parashikura për të parandaluar, reduktuar ose lehtësuar ndikimet negative;
  - g) Një përmbledhje të arsyeve për perzgjedhjen e alternativave të shqyrtuara;
  - h) Përshkrimin e masave të parashikuara për monitorimin e ndikimeve.

### 1.3.Pershkrimi I kuadrit ligjor dhe institucional

#### **Kuadri Ligjor Vendor dhe Nderkombetar**

Hartimi I kesaj VNM -je per zhvillimin e zones se projektit te pershkruar ne kapitujt ne vijim , eshte i mbikqyrur nga disa institucionet qendrore dhe ato lokale per zbatimin me rigoroz te te gjitha ligjeve dhe normave te parashtruara ne ligjet perkatese sipas institucioneve dhe kopentecave te tyre .Ne baze te legjislacionit, ky aktivitetet ndiqet nga keto institucione:

- Ministria e Mjedisit;
- Ministria e Bujqesise;
- Bashkite perkatese ne te cilen zona e projektit ben pjese administratisht
- Instituti i mjedisit;
- Instituti Hidrometeorologjik;

Kuadri ligjor vendor Legjisiacioni mjedisor eshte ndertuar per te mbrojtur dhe parandaluar komponente te vecante dhe te rendesishem te mjedisit. Keshtu, nder me specifiket mund te permendim:

- Ligjin Nr. 10 440, date 7.7. 2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”
- Ligjin Nr .10 431, date 9,6.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”
- Ligji 10448 date 14/07/2011 "Per lejet e Mjedisit"
- Ligjin Nr. 162/2014 ‘Per Mbrojtjen e cilesin se Ajrit ne Mjedis”
- Ligji Nr.9115 date 24.07.2003, “Per trajtimin mjedisor te ujerave te ndotura”.
- Ligji Nr.8897 date 16.05.2002, “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”.
- Ligji Nr.9379, date 28.04.2005, “Per eficencen e energjise”.
- Ligji Nr.9587, date 20.07.2006, “Per mbrojtjen e biodiversitetit”
- Ligji Nr.8906, date 6.6.2002 “Per zonat e mbrojtura”.I ndryshuar me:

Ligjin Nr.9868, date 04.02.2008

- Ligji Nr.10 ose, date 23.02.2009 per “Licencat, autorizimet dhe lejet ne Republikeri e Shqiperise”
- Ligji Nr. 8094 date. 21.03.1996: “Per largimin publik te mbeturinave”
- Ligji Nr. 9010 date 13.02.2003: “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta” I ndryshuar me :

Ligjin Nr.10 137, date 11.05.2009

- Ligji Nr.8102 date 28.3.1996 “Per kuadrin rregullator te sektorit te furnizimit me uje dhe te largimit dhe perpunimit te ujerave te ndotura”I ndryshuar me:

LJgjin Nr. 9352, date 3.3.2005

Ligjin Nr. 9915, date 12.5.2008

- Ligji Nr. 9537, date 18.5.2006 “Per administrimin e mbetjeve te rrezikshrne”I ndryshuar me:

Ligjin Nr.10 137, date 11.05.2009

- VKM. Nr. 575, date 24.06.2015 “Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte”
- VKM. Nr. 835, date 28.12.2005 “Per miratimin e listes se mbetjeve te rrezikshme, mbetjeve dhe mbeturinave te tjera, qe ndalohen te importohen, me qellim ruajtjeje, depozitimi dhe asgjesimi”
- V.K.M Nr.1189, date 18.11.2009 “Per rreguflat dhe procedurat per hartimin dhe zbatimin e programit kombetar te monitorimit te mjedisit”
- V.K.M Nr. 395, date 21.6.2006, "Per miratimin e strategjise dhe te planit te veprimit per zhvillimin e turizmit, kulturor dhe mjedisor"
- V.1CM Nr.435 date 12.09.2002, “Per miratimin e normave te shkarkimeve ne ajer ne Republiken e Shqiperise”
- V.K.M Nr.267, date 24.4.2003 “Per procedurat e propozimit dhe shpalljen e zonave te mbrojtura dhe buferike”
- V.K.M Nr,994, date 02.07.2008 “Per terheqjen e mendimit te publikut ne vendimmarrje per mjedisin”.
- VKM Nr. 99, date 18.2.2005 “Per miratimin e katalogut shqiptar të kiasifikimit te mbetjeve”
- VKM Nr. 177, date 31.3.2005 “Per normat e iejuara të shkarkimeve të lengeta dhe kriteret e zonimit te mjediseve ujore pritese”
- VKM Nr.114, date 27.01.2009 per “Marrjen e masave emergjente, per përmirësimin e situates se sigurisë dhe te veprimtarive ne instalimet, qe sherbejne per depozitimin transportimin dhe tregtimin e naftes, te gazit dhe nenprodukteve te tyre”.
- Vendim Nr.824, date 11.12.2003 Per kiasifikimin, ambalazhimin, etiketimin dhe ruajtjen e substancave dhe të preparateve te rrezikshme
- Udhezim Nr.6, date 27.12.2006, “Per miratimin e metodoiogjisë së vierësimit paraprakte ndikimeve ne mjedis të një veprimtarie”

- Udhezim Nr.6527, date 24.12.2004, "Mbi vlerat e ijeueshme të elementeve ndotes të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore, dhe menytrat e kontrollit të tyre"
- Udhezim, Nr.6, date 27.11.2007, "Per miratimin e rregullave, permbajtjes dhe afateveper pergatitjen e planeve të administrimit të mbetjeve të ngurta".

Shqipëria është një vend i cili është tashme nënshkruar i shumë konventave dhe marrëveshjeve mjedisore dhe kjo ka ndihmuar në nxitjen e hartimit të ligjeve kombëtare mjedisore në përputhje me praktikën ndërkombëtare. Ky raport duhet të përshatet me ligjet dhe aktet ligjore në nivel lokal dhe ato kombëtare dhe me poshte ilustrohen në mënyrë të përmbledhur etapat kryesore të zhvillimit të politikës europiane në fushën e mjedisit.

- Protokoli i Kievit :Per Vleresimin strategjik mjedisor.Ratifikuar në vitin 2005
- Protokoli i Kartagjenes:Per biosigurine.Bere pale ne vitin 2005
- Konventa e Stockholmit:Mbi ndotesit organike të qëndrueshem. Ligji nr. 9263, date 29.07.2004
- Protokoli i Kartagjens :Per sigurine biologjike.Ratifikuar ne vitin 2004.
- Ligji nr. 9279, date 23.09.2004
- Konventa e Ëashingtonit:Per tregetine nderkombetare të liojeve të rrezikuara të flores dhe faunes së eger. Ligji nr. 9021, date 06.03.2003.

### **Kuadri Ligjor European**

Raporti i VNM-se për projektin në fjalë, merr në konsideratë dhe mundohet të përjasë pjesë të tij me legjislacionin e BE mbi probleme mjedisore dhe jo vetëm. Direktivat më kryesore:

- Direktiva e KE 1999/30/CE 22 Prill 1999, për vlerat kufi për dioksidin e squfurit, dioksidin e azotit dhe oksidin e azotit, PM dhe plumbin.
- Direktiva 2000/60/CE e Parlamentit dhe e Këshillit të Europës, Kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave.
- Direktives KE 42/2001 (të Këshillit të Evropës), mbi VNMS dhe VSM.
- Direktiva 2008/50, CE, e Parlamentit dhe e Këshillit të Evropës (21 Maj 2008) "Mbi cilësinë e ajrit në mjedis, për një ajër më të pastër për Evropën".
- Direktiva 75/442/CEE e Këshillit e datës 14 Korrik 1975, Mbi Mbetjet.
- Direktiva 91/689/CEE e Këshillit e datës 12 Dhjetor 1991, Mbi Mbetjet e Rrezikshme.
- Direktiva 2001/42/CE e Këshillit dhe e parlamentit Evropian e datës 27 qershor 2001, Mbi vleresimin e Pasojave të Planeve dhe Programeve të Caktuara mbi Mjedisin.

- Direktiva 85/337/CEE e Keshillit e dates 27 Qershor 1985, Mbi Vleresimin e Pasojave te Disa Projekteve Publike dhe Private mbi Mjedisin.
- Direktiva e Keshillit 96/62/EC Mbi vleresimin dhe menaxhimin e cilesise së ajrit ne mjedis.
- Direktiva 1999/30/CE, Ne lidhje me vierat kufi per N02, NOx, S02, Iendet grimcore dhe Pbne ajër.
- Direktiva e Komisionit Evropian CEE/CEEA/CE 78/659 per cilesine e ujerave te embla
- Direktiva 99/61/CE Per gropat e mbetjeve.
- Direktiva 91/689/CE Per Mbetjet e Rrezikshme.

## 2. PERSHKRIM I PROJEKTIT

### 2.1. Qellimi i projektit

Qellimi i ketij projekti: **Ura Lidhëse për Fshatrat Vermosh - Velan - Velipojë ”, Njesia Administrative Kelmend ne Bashkine Malesia e Madhe**, eshte permiresimi e lidhjes se dy brigjeve te lumit, nepermjet mundesimit te kalimit te kembesoreve dhe makinave. Qarkullimi I makinave do te realizohet duke bere shkembim ne hyrje-daljet e ures, duke krijuar trup rruge te mjaftueshem per shkembimin e tyre.

### 2.2. Vendodhja e objektit

Sheshi i ndertimit te objektit ndodhet ne zonen e fshatit **Vermoshi te Bashkise Malesi e Madhe te Qarkut Shkoder**, ne mesin e ketij fshati. Ura qe projektohet lidh dy lagjet e ketij fshati. Gjeresia e lumit (zallishtes) ne kete segment eshte rreth 120 metra, por kjo gjeresi rritet duke kaluar pjeset e argjinaturave ne te dy anet e ketij lumi. Argjinaturat kane disiplinuar rrjedhjen e lumit, erozionin ansor (linear), mbrojtien e tokave bujqesore dhe te shtepive te banimit te fshatit Vermosh.





## 2.3. Te dhena teknike te objektit

### 2.3.1. Ura

Objekti ndodhet ne Vermosh, Nje. A Kelmend, Bashkine Malesia e Madhe, 84 km larg qendres se Koplikut dhe lidh dy anet e zonave qe ndan rrjedhja e ketij lumi. Aksi i ures ne projekt eshte perbri ures pasarel qe eshte aktualisht funksionale per lidhjen e dy zonave, dhe perpendikular me rrjedhjen e lumit. Prurjet e pakta ne sezonin e veres e benin te mundur kalimin pa veshtirsi te mjeteve ne te. Gjeresia e shtratit eshte e konsiderueshme, keshtu qe hapësira e drites e ures prej afro 19m secila i referohet shtratit te lumit i cili sjell prurjet ne forme rrekesh, perrenjsh ne gjurme te ndryshme. Ura do te kete lartesine e lire nga shtrati i lumit ( nga kuota e sistemuar ) 3m. Kjo lartesi i referohet dhe analizes hidrologjike te basenit. Lartesia ndertimore e ures varet kryesisht nga kushtet teknike te zbatimit te sektorit te xhenios, ushtrise.



### 2.3.2. Ura

Referuar prerjes terhore tipike te nje ure, ura beton arme do ndertohet me harqe ne procesin e ndertimit me faza. Pas ndertimit te bazamenteve te pilave dhe ballnave, ndertohet pjesa e poshteme e quajtur 'solete hark', ne fazen tjeter ndertohen muret b/a anesore hapsirave te cilave mbushet me zhavorr pas kalimit te diteve te nevojshme per marrjen e markes se soletes hark. Pjesa e zhavorrit mund te lihet bosh nqs nga sipermarresi merret persiper te lihet bosh duke lene armaturen e soletes se drejte te "vdekur" brenda, Pas kesaj vazhdohet me ndertimin e soletes se drejte dhe shtreses asfaltike. Gjeresia kaluese do te jete e dedikuar per nje kalim, dhe me mundsi shkembimi ne hyrj-dalje te ures ne karrexhaten e rruges qe eshte parashikuar si pjese e kesaj vepre.





Fig.1 Pamja ballore e piles se ures betonit






Fig.1-1 Pamja ballore e ballit te ures betonit




Fig.2 Planimetria dhe profile gjatesor i ures

### 2.3.3. Dimensionimi i ballit se ures


Mbeshtetja e ures eshte permasuar duke marre ne konsiderate :

-Thellesine maksimale te gerryerjes se shtratit te lumit te rekomanduar nga hidrogeologu e cila nuk eshte me e madhe se 3.5 metra.

-Thellesine e tabanit te dhene dhe rekomanduar nga studimi gjeologjik, sipas te cilit pllaka e themelit te mbeshtjes duhet te vendoset 4 metra me poshte se niveli I shtratit ekzistues.


-Niveli maksimal I ujit ne shtratin e lumit, i cili sipas llogaritjes nga studimi hidrogeologjik nuk del me shume se 1.2 metra. Kota e projektit te ures i referohet pervecse analizes hidrologjike, por edhe faktorve te tjere, sic eshte topografia dhe kushtet e terrenit per rrugët hyrse – dalese te ures.

Jasteku I ballit te ures eshte dimensionuar 640 cm x 130 cm x 80 cm. Balli I ures lidhet ne te dy krahet me shpatullat. Shpatullat e ures mbeshteten tek pllaka e themelit dhe formojne seksionin ne forme “U” duke lidhur me pjesen e ballit te ures. Trashesia e shpatullave ne vendin e takimit me pllaken jane 70 cm dhe lart ne nivelin e trupit te rruges jane 40 cm. Gjatesia e shpatulles ne vendin e mbeshtetjes se pllakes eshte 460 cm. Ndersa kjo gjatesi ne nivelin e rruges eshte 800 cm.



### 2.3.4. Dimensionimi i piles se ures

Pllaka e piles ka permasat 8.5m x 4m. Kuota e tabanit te saj do jete e njejte per te gjitha pilot dhe ballnat. Trupi i saj vin si paralepiped me ndryshim seksioni nga pllaka ne mbeshtetjen e jastekut te piles. Ky ndryshim seksioni vin per te ulur qendren e rendeses se piles dhe rezistuar forcave dinamike te rrjedhjes dhe siguruar mos permbyshjen. Jasteku ka permasa 5m x 1.5m mbi te cilin do montohet mbeshtetjet e mesit te ures tip .



## 3.PERSHKRIMI I MJEDISIT EKZISTUES

### 3.1. Gjeomorfologjia dhe Relievi

Fshati Vermosh perbene pjesen me veriore te Shqiperise dhe kufizohet ne perendim, veri dhe lindje me vijen kufitare me Malin e Zi, ndersa ne jug kufizohet me fshatrat Lopushe, Selce, Vukel etj. te Malesise Madhe te Qarkut Shkoder. Nga rajonizimi fiziko-gjeografik rajoni i Vermoshit i perket krahines se Alpeve Shqiptare, zones se Alpeve Prendimore, me relief bjeshkore, te prekura nga levizjet neotektonike te cilat i kane dhene pamjen e sotme morfologjike, me vargmale te lugines se Cemit, Selces dhe te Vermoshit, me coptime vertikale deri ne 400 m/km<sup>2</sup> dhe coptim horizontale 0,3 km/km<sup>2</sup>. Relievi i rajonit te Vermoshit si ne veri, jug, lindje e perendim eshte kodrinore e malore me kota deri 2100 m rralle me shume. Zona e fshatit Vermosh ka kuota 1090 deri 1250m, afersisht 4.0 km ne veri te ketij fshati ndodhet maja

e Marlules me lartesi 2186 m, ndersa ne jug ndodhet maja e Grebenit me lartesi 1840m. Lumi Vermosh me rrjedhje nga perendimi ne drejtim te lindjes formon nje lugine me shtrirje afersisht sipas lumit perendim-lindje ne mes te ketyre maleve te larta e te pyllezuara duke i dhene nje pamje turistike fshatit Vermosh dhe kesaj zone ne tersi. Relievi behet bjeshkore, kodrinore-malore dhe i thyer per shkak te ndertimit gjeologo-strukturor te gelqeroreve, gelqeroreve dolomitik e ranorik dhe flishit te cilet kane formuar monoklinale, sinklinale dhe antiklinale (te rrudhosur) te cilet duken shume qarte ne malet e zhveshura dhe ne luginen e lumit te Cemit ne fshatrat Lepushe, Selce, Vukel etj.

Keto struktura pervec rendesise gjeologjike e gjeoteknike kane rendesi e bukuri te vecante turistike, çdo vit po behen me te vizitueshme. Ne formimin e pejsazhit te sotem te zones kane ndikuar proceset e ndryshme gjeologjike si tektonikat dhe neotektonikat, erozioni, perajrimi, karstezimi, veprimtaria e ujrave siperfaqesore, akumulimi, ndryshimi i kushteve termodinamike, rreshqitjet, shembjet, ridepozitimi i mases se prishur si dhe veprimtaria e njeriut. Ne kohe te ndryshme here njeri, here tjetri faktor ka predominuar dhe kane sjelle ndryshime jo te njejta. Shpatet ku kryhet studimi paraqiten me relief te diferencuar. Fshati Vermosh ka nje siperfaqe toke bujqesore te kufizuar, meqenese siperfaqja dominuese e saj perbehet nga nje territor malore-kodrinore dhe nga prenia e shkebinjve gelqerore e flishor qe ndikon negativisht ne zhvillimin bujqesor te kesaj zone. Popullsia merret me blegtoria, me kultivim e hardhive dhe me prodhime

bujqesore e blegtorele dhe kohet e fundit me turizem malore i cili po rritet e zhvillohet nga viti ne vit. Pyllezimi ne pjeset periferike te Vermoshit eshte i zhvilluar, i perfaqesuara nga shkurret si shkoza, frasheri, lisi, pisha, ahu, geshtenja etj. te cilet mbrojne kete territore nga erozioni. Bimesia, reshjet dhe ujrat kane ndikuar qe te krijohet nje shtrese toke humusore, ku jane te zhvilluara shume bimet natyrore, mjeksore dhe kullotat. Ka tipe te vecanta bimesh qe takohen vetem ne kete zone. Ne pyjet e kesaj zone takohen kafshe te egra si dhelpra, ujku, lepuri, çakalli, ne pyjet e larta takohet kaprolli, dhija e eger, derri i eger, ariu i murem, rreqepulla, vjedulla etj.

### 3.2. Flora

Ne kete zone flora eshte shume e pasur, kemi nje llojshmëri të pafundme vegjitacioni si:

- pyje dushku dhe me pemë të tjera të ndryshme të larta,
- kullota alpine dhe nënalpine,
- pamje të shpateve të pjerrëta të maleve karbonatike dhe natyrore,
- përrenj që sjellin ujë në lumenjtë dhe zonat përreth,
- shpellë dhe zona të tjera të ngjashme, toka me lagështi të lartë, toka të punueshme,
- liqene në lartësi shumë të mëdha (pranë majave të malit), lumenj dhe përrenj të tjerë, etj.

Rriten rreth 1500 lloje bimësh, nga të cilat 100 janë bimë mjekësore dhe përfaqësojnë gati gjysmën e llojeve të florës së vendit tonë.

Ndër bimët më të rëndësishme të këtij kati janë: qarri (*Quercus cerris*), mëlleza (*Ostria carpenifolia*), shkoza (*Crapinus orientalis*), frashëri I bardhë (*Fraxinus ornus*), thana (*Cornus mas*), etj. Kati i ahut - shtrihet në lartësinë 700-1900 m. Si pasojë e kushteve të përshtatshme klimatikotokësore të favorshme, pyjet e ahut zënë pjesën më të madhe të parkut. Ndër bimët më të rëndësishme të këtij kati janë: ahu (*Fagus silvatica*), bredhi i bardhë (*Abies alba*), panja e malit (*Acer pseudoplatanus*), vallëza e egër, një dru deri 15 m i lartë dhe deri 15 cm i trashë, etj. Kati i kullotave alpine - shtrihet në lartësitë 1900-2300 m mbi nivelin e detit. Ky kat përbëhet nga bimë barishtore dhe pak shkurrëza siç janë: dëllinjat (*Juniperus*), shelgjet (*Salix*

sp), etj. Ndër bimët më të rëndësishme të këtij kati janë: flokëzi (*Poa alpina*), pirrgjaksja (*Sesleria nitida*), bishtpelza (*Festuk sulkata*), asteri (*Aster alpinus*), tërfili i alpeve (*Trifolium alpestre*), thuepule (*Lotus corniculatus*), etj. Në lartësinë 2300 m, mbi nivelin e detit, ndodhet kërleka ose centinaku (*Pinus mughus*), një lloj pishë në formë shkurreje me gjatësi deri në 3m.

### 3.3 Fauna

20 lloje gjitarësh, 50 lloje shpendësh folenizues, 10 lloje zvarranikësh dhe rreth 8 lloje amfibësh. Ndër gjitarët më të mëdhej të parkut janë: ariu i murrmë (*Ursus arctos*), ujku (*Canis lupus*), Rrëqebulli (*Lynx lynx*), dhia e egër (*Rubicapra rubicapra*), dhe kaprolli (*Capreolus capreolus*), etj. Në pyllin e lartë, nga shpendët mbizotërojnë kryesisht pjestarët e familjes së *Fragillidae* (4 lloje), dhe *Paridae* (4 lloje). Përbërës të tjerë më të rrallë janë elementë tipik të pyllit të lartë si: qukapikët (3 lloje), zvarritësi i drurëve (*Sitta europea*), etj. Lloje të tjera të hasura janë, gushkuqi (*Erithacus rubecula*), mëllenja (*Turdus merula*), larashi kurrizkuq (*Lanus collurio*), etj.

### 3.4. Ndertimi gjeologjik i rajonit

Zona e Vermoshit bene pjese ne Albanidet e Jashtme ne pjesen prendimore te saj. Ne ndertimin gjeologjik te rajonit takohen depozitime me moshe Jurasike, Kretake dhe te Kuaternarit. Pershkrimet e te cilave behen duke filluar nga ato me moshe me te vjeter deri tek ato me moshe me te reja si me poshte :

4/1. Depozitimet Triasikut te mesem (T<sub>2</sub>)

4/2. Depozitimet Jurasikut te siperm-Kretakut te poshtem (J<sub>3t</sub>-Cr<sub>2cm</sub>), Titonian i siperm-Cenomanian.

4/3. Depozitimet e Kretakut te siperm (Cr<sub>2m</sub>), Mastriktian

4/4. Depozitimet aluviale te Kuaternarit (Q<sup>a</sup>)

4/5. Depozitimet deluviale te Kuaternarit (Q<sup>d</sup>)

### 3.5. Kushtet Hidrogjeologjike


Zona e Vermoshit ku ndodhet fshati me te njejtin emer eshte i pasur me ujra siperfaqesore si, lumi i Vermoshit i Cemit dhe shume perroi e perrocka me ujra sezonale ne kohe dimri e shirash, gjithashtu takohen burime ujore dhe karstike te lidhura kryesishte me shkembinj ranore, gelqerore e karbonatike. Lumi i Vermoshit kalon permes fshatit Vermosh me gjatesi afersisht 22 km brenda territorit Shqiptar, me rrjedhje nga perendimi ne drejtim te lindjes, ndersa ne pjesen prendimore e jugprendimore te fshatit Vermosh ku lumi perbene pjesen e sipërme te rrjedhjes se tij ka drejtim rrjedhje nga jugperendimi ne drejtim te verilindjes me gjatesi afersisht 6 km ku lumi peson divijim rrjedheje nga perendimi ne drejtim te lindjes duke kaluar ne mes te fshatit Vermosh.

Lumi buron nga Alpet Shqiptare ne kuote mbi 1700 m. Ne pjesen e sipërme ka rrjedheje te shpejt e te vrullshme duke formuar lugina te thella dhe te ngushta ndersa ne pjesen e mesme te



rrjedhjes ne fshatin Vermosh formon lugin te gjere. Lumi i Cemit fillon rrjedhjen afersisht 5 km ne jug te Vermoshit nga zonat e Selces dhe vazhdon rrjedhjen ne drejtim te JP ne drejtim te Tamares. Ky lum buron nga Alpet Shqiptare e derdhet ne Moraçe me rrjedhje nga verilindja ne drejtim te jugperendit. Ne pjesen e sipërme ka rrjedheje te shpejt e te vrullshme duke formuar lugina te thella dhe te ngushta ndersa ne pjesen e poshtme ne fushen e Cemit ka rrjedhje te ngadalte. Perronjt e zones Vermoshit kane gjatesi deri 3 km me rrjedhje afersisht perpendikular me aksin e lumit Vermosh dhe derdhen ne kete te fundit. Ne kohe shirash e dimri rrisin prurjet e tyre. Klima eshte mesdhetare - kontinentale. Ne dimer temperature arrin deri - 25<sup>0</sup> dhe ne vere deri ne + 32<sup>0</sup>. Reshjet ne pergjithesi jane te karakterit mesdhetar, mesatarja vjetore arrijne 2500-3000mm. Nga analizat e kryera rezulton se jane ujra natyrale, ato nuk jane agresive ndaj hekurit dhe betonit.

- Duke pare se pellgu shimbledhes ne aksin ku do te ndertohtet ura eshte 5 809 ha bejme llogaritjet hidrologjike duke perpunuar reshjet maksimale 24 oreshe per Stacionin Pluviometrik me te afert ate te Vermoshit.





**Perpunimi reshjeve maksimale 24 oreshe Stacioni Pluviometrik Vermosh**

NR	VITI	RESHJE 24 h MAX.	VITI	RESHJET DITORE RENDITUR	P % $P=m/n+1*100$ %	K= H1d/Hmes	K-1		(K-1) <sup>2</sup>	P %	Kp	Hp
							+	-				
1	1973	101.4	1986	197.3	8.33		0.797		0.6333	1	5.82	638.8
2	1974	121.4	1974	121.4	16.67	1.106	0.106		0.0112	2	4.58	501.0
3	1975	82.3	1977	119.4	25.00	1.088	0.088		0.0077	3	3.84	421.5
4	1976	111	1979	118.4	33.33	1.079	0.079		0.0062	5	3.07	336.9
5	1977	119.4	1976	111.0	41.67	1.011	0.011		0.00012	10	2.18	239.3
6	1978	105.2	1978	105.2	50.00	0.958		0.042	0.0018	20	1.43	156.95
7	1979	118.4	1973	101.4	58.33	0.924		0.076	0.0058	25	1.27	133.9
8	1982	77.9	1987	90.8	66.67	0.827		0.173	0.02993	30	1.06	116.35
9	1983	82.3	1983	82.3	75.00	0.75		0.250	0.0625	40	0.81	88.9
10	1986	197.3	1975	82.3	83.33	0.75		0.250	0.0625	50	0.63	69.15
11	1987	90.8	1982	77.9	91.67	0.71		0.29	0.0841	60	0.49	53.78
										70	0.38	41.7
										75	0.32	35.12
										80	0.27	29.63
										90	0.18	19.75
										95	0.12	13.17
										97	0.10	10.98
		1207.4		1207.4			1.081	1.081	0.90515	99	0.03	3.29

**Treguesit e Pellgut shimbledhes**

Siperfaqja e pellgut shimbledhes eshte  $F = 5\ 809$  ha

Gjatesia e perroit mesatarisht 6.5 km

Pjerrësia mesatare e perroit deri ne aks eshte  $i = 0.029$

Gjeresia mesatare e shtratit 10 m

**Per nga rendesia e vepres, nisur nga normativat e projektimit do te punojme me prurjen llogaritese me 2 % siguri dhe prurjen kontrolluese me 1 % siguri.**

**4. VLERSIME TE NDIKIMEVE NE MJEDIS****Ndikimet ne terren dhe peisazh**

Terreni dhe impaktet vizuale do te theksohen me shume gjate fazes se ndertimit dhe ne nje kohe te shkurter keshtu qe sherbimet nuk jane shumete nevojshme apo jane te limituara ne perdorimin e tyre. Pronat e aferta jane mjaft larg nga projekti. Interferencat e projektit me kontekstin vizual te tyre do te mbetet e ulet. Godinat e trashegimise jane gjithashtu mjaft larg rruges keshtu qe konteksti vizual i tyre nuk do te ndryshohet shume nga projekti.

Impakti i pergjithshem nga afatshkurter deri ne afatmesem ne projektin e propozuar te karakterit te terrenit eshte konsideruar te jete ne nivelin e ulet.

**Dherat dhe Ri-shfrytezimi i materialeve te germuara**

Materialet e germuara qe jane te menduara per rishfrytezim do te menaxhohen dhe trafikohen den ne minimum dhe do te depozitohen ne nje menyre qe te minimizohet efekti i motit. Koha ndermjet germimit dhe rishfrytezimit gjate periudhave te thata do te mbahet ne nje minimum.

Gjate periudhave te zgjatura te thatesires kontraktori do te ndaloje germimet dhe do vendose keto materiale per te parandaluar degradimin per shkak te thatesires.

Ndikimi gjate fazes se Funksionimit dhe Masat Lehtesuese

Ne perfundimin e ndertimit do te kryhen inspektime vizuale ne te gjitha strukturat e projektit, per te siguruar se nuk shkaktojne erozion, dhe qe te identifikojne kerkesat per kryerjen e cdo punimi riparues. Kjo mund te ule impaktin e mundshem ne te ardhmen per humbjen e dherave dhe impaktet qe lidhen me terrenin te shkaktuara nga erozioni.

## **Ndikimet gjate fazes se ndertimit per hidrologjine, ujerat sipërfaqesore dhe nentokesore**

### **Ujrat Nentokesore**

Ekziston mundesia per ndotjen e ujrave nentokesore nga derdhjet e impiantit te ndertimit dhe derdhjet aksidentale te gazrave dhe karburanteve. Do te merren masa te pershtatshme per kontrollin e impianteve te cilat do kryhen nga Kontraktoni gjate ndertimit per te zvogeluar sa me shume impaktet.

- *Ne ujerat nentokesore si rezultat i cpimeve dhe germimeve per themelet apo derdhjet aksidentale te karburanteve dhe vajrave gjate ndertimit nga automjetet e ndertimit dhe makinerite qe perdoren pa kriter gjate menaxhimit te veprimtarive te ndertimit;*
- *Ne ujrat sipërfaqesore si rezultate i nderprerjeve te vazhdueshme te perkohshme nga kanalet o dranzhimit apo ndotja pa kriter gjate menaxhimit te veprimtarive te ndertimit;.*

### **Ndikime ne cilesine e ajrit**

Gjate fazes se ndertimit emetimi i pluhurit eshte i lidhur me aktivite te ndryshme si psh langimi i pemeve dhe i shtreses se punueshme, germimi i materialit tokesor dhe vendosja e te njejt material ne argjinatura dhe ne ndertimin e strukturave. Emetimi i pluhurit varet separi ne kushtet e motit dhe ne nivelin e aktivitetit dhe te llojit te veprimeve qe do kryhen.

Gjithashtu pluhuri ngrihet nga rrotat e automjeteve te renda te ndertimit ndersa ato kalojne pergjate vendit te ndertimit gjate kushteve te motit te keq. Rezervat e materialeve te humbura mbahen zakonisht ne kushte te hapura per shkak te nevojës per akses te vazhdueshem tek te nga ekskavatoret dhe ngarkuesit etj. Emetimi i pluhurit nga keto materiale rezerve mund te dale si shkak i ketyre aktiviteve: - Formimi i rezervave duke perdorur metodat e rripit transportues; - ndikimi i ererave te forta; dhe - ngarkimi i kamioneve per transport ne vendet e punimeve. Ne zonen ne fjale, zonat qe do te vuajne me shume per shkak te emetimit te mundshem te pluhurit gjate ndertimit jane ato te afer rruges. Megjithate rekomandohet qe veshqimi i cilesise se ajrit ne zonat perreth vendeve ku eshte ndermarre ndertimi gjate procesit te ndertimit ne menyre qe te shfaqet sa me heret te jete e mundur cdo problem qe del nga emetimet si pasoje e procesit te ndertimit. Por duhet te theksohet se menaxhimi i mire i vendeve te ndertimit dhe planifikimi i punes duhet te organizohet ne nje menyre te tille qe te ruhen efektet/ndikimet nga emetimet e vendit deri ne periudhen me te shkurter te mundur.

### **Ndikime ne nivelin e zhurmave**

Emetimet e zhurmes nga vendet e ndertimit do te ndikohen edhe nga perdorimi i makinerive medha qe mund te provokojne bezdi dhe zhurma si psh, venia e shtyllave etj. Zhurma mund te krijohet nga shume veprime ndertimi dhe varet nga faktore si: lloji i pajisjes, veprimet qe do te kryhen dhe makinerite qe dote perdoren-kushtet e makinerive dhe makinat

e perdorura. Leq (niveli ekuivalent) per disa faza ndertimi varet edhe nga gjatesia e kohes qe aparti eshte ne veprim. Lloji dominues I zhurmes per shumicen e pajisjeve te ndertimeve eshte motorri, zakonisht me nafte dhe pa silenciator. Ne pak raste si psh per nje shofer-grumbullimi apo nje vegelthyses pneumatike betoni, dominon zhurma e shkaktuar nga kryerja e veprimit.

## **5. MASAT KRYESORE LEHTESUESE**

### **Masat Lehtesuese per Terrenin dhe Peisazhin**

#### *Faza e Ndertimit*

Kontratit do te lidhen ne menyre qe te sigurohet nje praktike sa me e mire pune si edhe qe te zvogelohen impaktet negative qe vijne si rezultat i ndertimit ne nivelin mete ulet te mundshem dhe qe sigurojne makinerite qe operojne brenda skemes ne zonen e ndertimit i zbatohet ato. Zonat e depozitimit do te pozicionohen ne menyre qe te menjahen impaktet e metejshme ne pronat private e banesat ekzistuese, pemet, gardhimet, dranazhimet etj. dhe site tilla do te kene prioritet per tu ndertuar. Natyra e perhershme e impakti do te ndikojte gjithashtu ne pronat e shtepive private perreth vetem ne ato seksione ku kjo prone eshte ne afersi te projektit te propozuar. Megjithate, sherbimet lehtesuese jane kryer per te minimizuar ne maksimum impakte te tilla te banoret.

### **Masat e lehtesimit per hidrologjine, siperfaqet dhe ujerat nentokesore**

#### **Faza ndertimore**

Masat e kontrollit te ndotjes do te vendosen ne vend gjate procesit te ndertimit. Kjo do te perfshije pajisjen e skelave dhe gardhimet prej balte. Rezervat e materialeve te ndertimit, si asfalti, vaji dhe kimikatet nuk dote vendosen afer asnje siperfaqeje te vijave ujore, apo puse uji. Rezervat do te vendosen ne siperfaqe te mbyllura, te mbuluara me shtresa (carcarfe) mbylles ose me rize cati me te qendrueshme ose e rrethuar nga nje porte per te parandaluar humbjet. Rezervat do te mbrohen per te parandaluar vandalizmin dhe vjedhjen qe mund te coje ne humbje. Gjate fazes se hedhjes se betonit, e nevojshme per ndertimin e strukturave (pirgjeve, plintave, mureve mbajtese) ne menyre qe te shmaget shperthimi i ujit dhe prishja e betonit ne toke dhe ne ujera nentokesore, do te merren disa masa si psh pozicionimi i mbrojtjes se mbuleses per te mbajtur derdhjen. Largimet nga vendndodhjet e shkaktuara nga aktivitetet e kantierit te ndertimit do te trajtohen ne perputhje me llojin e tyre. Uji qe vjen nga Iarja e makinave dhe nga pajisja, do te trajtohet me ane te sedimentimit ne nje rezervuar stabilizimi (funderrimash) per pjese te rendomta dhe nderprerje vajerash per te lejuar pjeset e vockla dhe vajerash qe te eliminohen. Uji qe vjen nga Iarja e agregateve dhe nga prodhimi i konglomerateve do te trajtohet me ane te sedimentimit ne rezervuare dhe pastaj te perdoret perseri ose te dergohet ne nje vend tjeter. Ne rastin e nje firoje te kimikateve ose rrjedhjeve gjate ndertimit, do te vendoset nga kontraktuesi nje program i masave te siperfaqeve dhe ujerave nentokesore.

### **Masat lehtesuese per cilesine e ajrit**

#### Faza ndertimore

Masat qe rekomandohen me shpesh ne lidhje me punimet tokesore konsistojne ne:

- Zbatimi i sistemeve te shuarjes se pluhurit: ujitja e anesoreve te rrugeve, perdorimi I mjeteve ruajtese per te kufizuar emetimet e pluhurit (per shembull: perdorimi I mekanizmave/karuselve lares ne cdo zone magazine, te cilat mbahet perdite);
- Kufizimi i shpejtesise se mjeteve ne rruge.

Ne menyre qe te mbahet/ruhet cilesia e ajrit dhe te shmanget shkaktimi i ndonje ngaterrese tek banoret lokale, eshte e keshillueshme qe stabilizimi i tokes/baltes (gelqere e pashuar, kordonet hidraulike) duhet te behet vetem:

- Gjate periudhave me ere te ulet;
- Ne zonen e ekstradimit/prejardhjes;
- Ne sektoret e vecante ne mes zonave ku nuk ka mbjellje te ndjeshme, ne menyre qe te perfshihet ne menyre te natyrshme pluhuri ajror.

Reduktimi i ndikimeve te ndertimit perfshin gjithashtu:

- Linjat e transportit te perdorura per shperndarjen e materialeve.

Faza e funksionimit

Nivelet e trafikut te projektuara me afat te gjate jane relativisht te uleta dhe mundet te shkaktojne emetime te pakta duke marre parasysh edhe permiresimin ne emetimet unike te automjeteve ne te ardhem meqenese industria e vjeter e gazrave te makines eshte zevendesuar. Rruga ne fjale nuk duhet te krijojte nje rritje te emetimit qe vjen nga makinat, meqenese emetimet varen nga lloji i makines, mirembajtja e motorrit, dhe nga shpejtesia e makines. Nga njera ane, nje siperfaqe uniforme rruge do te na coje ne shpejtesi me konstante, qe do te shkaktojte ulje te emetimeve. Edhe sasia e pluhurit qe perhapet nga kalimi I makinave do te ulet, meqenese do te zhduken gropat ne rruge. Nga ana tjeter pritet nje rritje e shpejtesise se makinave ne rrugen e re e cila mund te rrise lehte emetimet.

### **Masat lehtesuese per nivelin e zhurmave**

Keto masa do te sigurojne qe:

- Asnje implant i perdour ne vend nuk do te lejohet te shkaktojte nje bezdi publike si pasoje e zhurmes,
- Me e mira eshte: zbatueshmeri duke perfshire mirembajtjen e duhur te impiantit dhe angazhimin per te ulur zhurmen e krijuar nga veprimet ne vend.
- Te gjitha makinat dhe impiantet mekanike do te pershtaten me silenciator efektive dhe te mbajtur ne funksion te mire gjate kohes se kontrates,
- Kompresoret do te jene modele lehtesuese te pershtatura me kapake akustike te duhur me viza dhe te mbyllur te cilet do te mbahen te mbyllur kurdo qe makina punon dhe te gjitha mjetet vartese pneumatike do te pershtaten me silenciatore.
- Makineria qe eshte perdorur pa nderprerje do te fiket ose ti ulet shpejtesia ne minimum (ose ti mbyllet valvula) gjate periudhes kur nuk perdoret.
- Cdo impiant si psh gjenerator ose pompe, qe kerkohet te veproje para dhe pas oreve te ligjshme te punes, do te rrethohet nga nje mbyllje akustike ose nga ndonje mbylles portativ.

Gjate fazes se ndertimit te projektit, do te kete ca ndikim ne ose afer pronave te banimit dhe biznesit si pasoje e emetimeve te zhurmes nga vendi i trafikut dhe aktivitetet tjera. Kerkesa per heqjen e kufizimeve te zhurmes dhe oreve te punes, pergjate zbatimit te masave te duhura te kontrollit te zhurmes, do te siguroje qe efekti i zhurmes eshte mbajtur ne minimum.

***Përmbledhje e masave per eliminimin e ndikimeve ne mjedis***

Aktiviteti	Impakti	Masat për zbutjen e ndikimeve	Monitorimi që kërkohet
Planifikimi i Projektit dhe Faza e Projektit			
Vlerësimi i gjendjes ekzistuese dhe Projekti i ndertimit te ures.	Nuk ka në këtë faze ndjeshmëri mjedisore por është e rëndësishme që të parashihen impaktet potenciale për të marrjen e masave të përmirësimit dhe monitorimit.	Sigurimi i bashkëpunimit midis ekipeve te projektit dhe vleresimit mjedisor.  Përdorimi i një “Environmental Checklist” është i domosdoshëm që në planifikim.	Vizitë paraprake në terren dhe biseda me autoritetet lokale janë të nevojshme.
Faza e ndertimit			
Modifikimi i sipërfaqes së tokës si rezultat i rrugeve që do të hapen provizorisht për të transportuar materialet gjatë fazes së ndertimit.	Dëmtim i sipërfaqes dhe kompaktësimi i saj. Rreziku nga erozioni rritet duke transportuar granula dhe grimca toke drejt pellgjeve ujore.	Rigjenerimi i bimësisë ekzistuese dhe/ose zëvendësim i tyre me bar pas përfundimit të punimeve. Sipërfaqet e shkelura nga makinat dhe mjetet e tjera të rënda të rehabilitohen.	Monitorimi i sipërfaqeve të dëmtuara dhe atyre që do të rehabilitohen në fund të projektit. Drenazhet natyrore /artificialë të funksionojne si më parë dhe të mos ketë erozion.
Modifikimi i sipërfaqes së tokës si rezultat i depozitimit te materialeve qe do te perdoren per ndertimin e ures.	Dëmtim i të mbjellave të fermerve në zonat e kultivuara dhe i sipërfaqeve kullimore dhe pyjore në zonat kodrinore.  Dëmtim/mbushje me dhe të kanaleve	Kujdes i lartë në fusha për të bërë sa më pak dëmtime në të mbjella.  Të ndërtohet një grafik punimesh dhe te respektohet duke eliminuar oret e pushimit të drekes dhe mbrëmjeve.	Monitorim gjatë ndertimit. Në fund të projektit duhet të krahasohen dëmtimet e bëra (direkt nga rimbursimet e kryera) dhe planifikimi sipas projektit.

	<p>kulluese dhe/ose tombinove që sigurojnë funksionimin normal të mbikalimeve dhe rrjedhave ujore.</p> <p>Zhurmat do të jene prezente gjate ndërtimit te ures (hapje traseje, sheshim dhe germim).</p> <p>Pluhuri dhe gazet që emetohen nga puna e mjeteve të rënda apo transportit.</p>	<p>Të laget traseja aty ku pluhuri eshte intensiv dhe kontrollohet gjëndja e mjeteve të transportit dhe punimeve</p>	<p>Monitorimi paralelisht i punimeve dhe i menjehershem pas përfundimit të punimeve të ndërtimit.</p> <p>Ndalon puna menjëherë dhe vihet ne dijeni pergjegjesi i punimeve, i cili nga ana e tij vë ne dijeni autoritetet respektive Malesi e Madhe.</p> <p>Monitorim për zbatimin e orareve të punimeve nga kontraktori, Bashkia Malesi e Madhe.</p>
<p>Rritja e erozionit sipërfaqësor si rezultat e gërmimeve në vendin ku ndertohej ura.</p>	<p>Ndihim në hidrologjine dhe në burimet ujore për shkak të ndryshimeve në drenimin/rrjedhjen lokale të ujit dhe përmbytje të terreneve të afërta.</p>	<p>Të sigurohen që të gjitha modifikimet e bëra që mund të shkaktojnë rritjen e erozionit të eliminohen tërësisht sipas një plani masash rehabilituese të parashikuar që në fillim të punimeve.</p>	<p>Kontroll të një pas njëshëm ne vendin e ndertimit te ures.</p>
<p>Gërmime të thella gjatë ndërtimit të ures .</p>	<p>Ndihim në biodiversitet për shkak të largimit të shtresës sipërfaqësore të tokës dhe mikrofauna dhe fauna e cila ndodhet në thellësinë e germimit. Humbje të mundshme të specieve të florës dhe faunës lokale.</p>	<p>Të sigurohen që materiali I germuar te transportohet ne vendin e caktuar per depozitim nga Bashkia Malesi e Madhe.</p>	<p>Verifikim që rehabilitimi mjedisor është bërë korrekt dhe në se është e nevojshme të rregullohen hapsirat dhe të rimbillen specie bimore lokale.</p>
<p>Gjenerimi i mbetjeve të ngurta : zhavorr, rëre, llaçi, dërrasa, etj</p>	<p>Ndihim në ndotje e vendeve të sheshit të ndërtimit për shkak</p>	<p>Të sigurohemi për personel të trajnuar të cilët do të kujdesen për depozitimn e mbetjeve</p>	<p>Te sigurohemi që mbetjet solide ose të tjera ndotëse të jene grumbulluar,</p>

	mbetjeve të ngurta, vajra motorash, etj.	si dhe pajisjet e domsodoshme të siguruara nga kompania ndërtuese.	transportuar dhe depozituar konfrom rregullave.
--	--	--	---

## 6. PERFUNDIME DHE REKOMANDIME

- Perfundimi me i rendesishem eshte se projekti nuk ka asnje ndikim negativ ne mjedis.
- Gjate aktivitetit te ndertimit te Ures dhe gjate funksionimit te saj nuk do te shkatohet ndotje e tokes, ajrit, ujit.
- Te evitohet ne maksimum rrjedhja e vajrave nga automjetet dhe mjetet e ndertimit
- Te ndertohet me parametrat e duhur, duke marre parasysh ngarkesen maksimale; kushtet gjeologjinxhinjrike te truallit; dhe mikrozonimin sizmik te sheshit te ndertimit. Te ruhen themelet e ketyre veprave nga erozioni.
- Transporti i mjeteve te ndertimit dhe transportimit (kamione veteshkarkues, buldozere, fadroma, betoniera, vinca, etj.), ne rruget permes qendrave te banuara, te kryhet me shpejtesi te vogel, per shmangjen e pluhurave
- Te evitohet ne maksimum rrjedhja e vajrave nga automjetet dhe mjetet e ndertimit (ekskavatore, fadroma, vinca, betoniera, etj.) -Te parashikohen mjete dhe mundesi per mbledhjen e vajrave ne rast derdhjeve aksidentale ne toke dhe ne rrjetin e kanaleve kullues e vadites.
- Transporti dhe depozitimi i dherave te germimeve ne terrene te paracaktuara. Te shmanget hedhja e dherave te germimit ne shtratin e lumit.

Si perfundim mund te themi se efektet e ndertimit te **objektit “ Ura Lidhëse për Fshatrat Vermosh - Velan - Velipojë ”**, Njesia Administrative Kelmend ne Bashkine Malesia e Madhe, do te jene pozitive duke patur parasysh edhe kriteret e duhura per mbrojtjen e mjedisit.

Analizat e mësipërme nuk nxjerrin në pah ndonjë impakt negativ ose ndikim mbi ujin nëntokësor/akuiferët dhe mbi ndonjë prej instalimeve që lidhen me furnizimin e ujit të vendbanimeve.

Gjate zbatimit te projektit duhet te merren ne konsiderate te gjitha opinionet e dhena ne kete studim ne lidhje me masat monitoruese qe duhet te ndermerren gjate zbatimit te punimeve.

**PUNOI: Ing. hidro. Burhan HAFIZI**  
**Ing. mjedis Gabriela PALUCA**